



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 26 dt. 30.05.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, si dhe të nenit 22, pika 3, të rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e liçensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 30.05.2014, pasi shqyrtoi materialin mbi mungesën e drejtuesit teknik për shoqërinë “TPLAN” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Heqjen e liçensës së restaurimit R.SH.18 për shoqërinë “TPLAN” sh.p.k.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, heqjen e liçensës në fushën e restaurimit R.SH. 18, për shoqërinë “TPLAN” sh.p.k., me drejtues ligjor Z. Flamur Buçpapaj.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

Red. publikim: M. D. R. D.

DKC E. V. V.